# DËSHMI ARKIVI

**A-468664**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Zjarr i madh në një traget pranë Mykonos, evakuohen 29 persona/ Flakët nisën nga një kamion |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/25/zjarr-i-madh-ne-nje-traget-prane-mykonos-evakuohen-29-persona-flaket-nisen-nga-nje-kamion/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 11:45:51 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 25 shtator 2026, 11:39:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 25 shtator 2026, 11:38:00 UTC → 25 shtator 2026, 11:40:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `c0b5d07d826aa408a0dbf0175048bb1254ca39775ec61dc6dfec8a47edad2ecd` |
| TEKSTI | `14c7118cc331079bd168bdb3a47f8a1589fec7d2075bfd9cb741e265f7f56c78` |
| PAMJA | `248dab01d4707baa25d55e893a64cc82a1f78ec121a38d779893e4fa02996e4f` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `262620b9f4f53a11b87b7a0ab307c3dec5719cbdbfbbf4aaec4928792969a638` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `3f529bf32420afe1b21bc6d3b8138bcb5df45885bcaf02ba5967dcac0a879fe4` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/262620b9f4f53a11b87b7a0ab307c3dec5719cbdbfbbf4aaec4928792969a638`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA KRYESORE TË FUNDIT

# Zjarr i madh në një traget pranë Mykonos, evakuohen 29 persona/ Flakët nisën nga një kamion

25/09/2026 13:39




**Një zjarr i madh shpërtheu të premten në tragetin Ro-Ro BLUE CARRIER 2, ndërsa lundronte në veri të Mykonosit dhe në lindje të Androsit, në Greqi.**

Në bord ndodheshin 29 persona, 28 anëtarë ekuipazhi dhe një shofer kamioni, të cilët u evakuuan në mënyrë të organizuar dhe u transportuan në Tinos nga anijet e Rojës Bregdetare. Sipas kompanisë, të gjithë janë në gjendje të mirë shëndetësore dhe nuk është raportuar asnjë i lënduar.

Zjarri shpërtheu rreth orës 08:57, ndërsa anija po ndiqte itinerarin e planifikuar nga Pireu drejt Vathit të Samosit. Sipas të dhënave paraprake, flakët nisën nga një kamion në garazhin numër 4 dhe u përhapën me shpejtësi, duke bërë që ekuipazhi të kërkonte ndihmë nga jashtë.

Në pamjet e publikuara në rrjetet sociale shihen përpjekjet e ekuipazhit për të vënë nën kontroll flakët, ndërsa në radio dëgjohen komandat për evakuimin. Në një moment dëgjohet edhe urdhri: "Shpejt, përgatitni anijet".

Nga garazhet e tragetit janë dëgjuar edhe shpërthime, ndërsa në zonë u dërguan anije zjarrfikëse dhe mjete të tjera nga Syrosi, Mykonosi, Lavrio dhe Pireu, si dhe anije që ndodheshin pranë vendngjarjes.

BLUE CARRIER 2 ishte nisur nga Pireu dhe kishte mbërritur pranë Syrosit rreth orës 06:30 të mëngjesit. Më pas, anija po vijonte drejt Vathit të Samosit. Itinerari i planifikuar ishte Pireu-Syros-Vathi-Kos-Rodos-Kos-Pireu.

Sipas kompanisë pronare Attica Group, menjëherë pas shpërthimit të zjarrit u aktivizuan procedurat e sigurisë dhe u krye evakuimi i organizuar i të gjithë personave në bord.

Anija transportonte 166 kamionë dhe 29 automjete, ndërsa shkaku i saktë i zjarrit mbetet ende nën hetim. Kushtet e motit në zonë raportohet se janë relativisht të favorshme, me erëra deri në 4 Beaufort.

Kompania bëri të ditur gjithashtu se ka angazhuar kompani të specializuara për të ndërmarrë masat e nevojshme për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e situatës së anijes, në bashkëpunim me autoritetet kompetente.

BLUE CARRIER 2 është një anije mallrash Ro-Ro me flamur grek, e ndërtuar në vitin 1997, me gjatësi rreth 162.5 metra dhe tonazh bruto prej 23,986.

**Top Channel**

## Bota »





## Kryesore



**Anulohet tenderi 50 milionë euro për hemodializën, ministrja e re e Shëndetësisë ndalon procedurën**
13:33

**Plagosja me armë në Lezhë/ Kamerat e sigurisë zbardhin konfliktin, autorët u larguan me makinë, shpallen në kërkim**
09:59

**Moti 'përmbys' planet e pushuesve, shiu dhe era boshatisin Lungomaren në Vlorë**
10:41

**Përplasje për zgjedhjet në Brazil/ 31 ligjvënës amerikanë akuzojnë administratën Trump për ndërhyrje**
09:47

**Kuqezinjtë nisin misionin e ri në Nations League, të gjitha emocionet live dhe ekskluzivisht në DigitAlb**
10:27

## Më të lexuarat

**"Ku jemi katandisur!"/ Ish-deputeti Murrizi nxjerr videon e sherrit në Durrës: Ky që e rrahin si gomarin në duhan është shefi i Komisariatit Krujë**

**"Dumani përzuri Vlorën nga zyra", Murrizi bën deklaratën e fortë në Top Story: E nxori nga qershori i 2025**

**"Ke kaluar nga zyra e Ergysit që u bëre deputete?"/ Ministrja Ismaili i përgjigjet fjalës së Berishës në Kuvend: Tek Agasi isha bashkë me Argitën**

**Top Story/ "Kërkoi ekspertim të telefonit jashtë Shqipërisë", gazetarja Hoxha zbardh detajet nga seanca me dyer të mbyllura, çfarë deklaroi Vlora Hyseni në SPAK**

**"Burg, burg", një grup protestuesish përplasen me Çuçin dhe bashkëshorten në kafene, si përgjigjet deputeti i PS dhe Delina Fico**

**Bllokohen specat dhe açuget/ Jo vetëm perimet, Shqipëria ka probleme edhe me produktet e detit. Bllokohen në Itali**

**Akuzohet për përvetësimin e 700 mijë eurove nga Posta Shqiptare, lirohet nga burgu ish-drejtoresha, Elisabeta Mataj**

**Top Story/ "Mbrojtja do jetë arrogante", Vangjeli për deklaratën e Vlora Hysenit: Po shantazhon njerëzit me pushtet. Pretendimi i saj për Agasin, i gënjeshtërt**



Greqia po kthen trurin/ Përmirësimi i ekonomisë, kthehen grekët e kualifikuar që emigruan në Gjermani

25/09 13:25



Alarm në detin Egje/ Përfshihet nga zjarri një traget, evakuohen 29 persona

25/09 13:18



Vdekja e Giorgos Mazonakis, dalin detaje të reja nga klinika: Defibrilatori nuk po funksiononte

25/09 13:02



Aeroporti i Milanos merr emrin e Silvio Berlusconit, riemërtimi shkakton debate

25/09 13:02



Putin e fton, Zelensky thumbon: Në Moskë do të shkoj me raketë

25/09 12:59



Italia ndalon burkën në shkolla/ Kryeministrja Meloni mbështet masën: Nuk pranohet fshehja e fytyrës

25/09 12:53

Detaje nga përplasja në rrugët e Durrësit/ Pronari i hotelit që u shemb gjatë tërmetit goditi shefin e komisariatit, si u mbyll ngjarja pa denoncim

Top Story/ "Hakmarrja është intimidimi i Klodiana Lalës", Murrizi për Vlora Hysenin: Ajo e di kush ka hyrë e kush ka dalë nga zyra e Agasit

## Kryesore »



Anulohet tenderi 50 milionë euro për hemodializën, ministrja e re e Shëndetësisë ndalon procedurën

25/09 13:33



Shkopinj bejsbolli dhe sherr mes të miturve në Yzberisht, policia parandalon përplasjen dhe procedon penalisht 23 të rinj

25/09 13:29



"O hajdut, burg"/ Delina Fico zbulon për "Shqipëria Live" se çfarë ndodhi në incidentin me protestuesit: Kishin 5 minuta që shanin, hapen kamerat vetëm...

25/09 13:24



Alarm në detin Egje/ Përfshihet nga zjarri një traget, evakuohen 29 persona

25/09 13:18



Detaje nga përplasja në rrugët e Durrësit/ Pronari i hotelit që u shemb gjatë tërmetit goditi shefin e komisariatit, si u mbyll ngjarja pa denoncim

25/09 13:14



Vdekja e Giorgos Mazonakis, dalin detaje të reja nga klinika: Defibrilatori nuk po funksiononte

25/09 13:02

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top News – 'Largohuni frikacakë'. Izraeli mban shënim shtetet që e bojkotuan në OKB



Top News – Trump i dëbon, Papa i afron: 'Të gjithë gazetarët janë të mirëpritur'



Top News – Rendi i ri botëror i Erdoganit / Turqia nuk do zgjedhë mes lindjes dhe perëndimit










Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.